



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:249411
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05459796

C-IV-14-6067

Ankuesi

H D, Fshati P, Prizren

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 15 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET Vendimi i Autoriteti i Likuidimit, Nr. PRZ018-0085, i datës 18 gusht 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 08 shtator 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër vendimit nr. PRZ018-0085, të datës 18 gusht 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për 3 paga të pa paguara, për periudhën kohore janar, shkurt, mars 2007, në shumë prej 900.00 €, nga NSH “Unimont”- Prizren (në likuidim). Ankuesi ka pohuar se arsyetimi i vendimit të AL-së është i pa qëndrueshëm sepse thirret në dispozitat ligjore regresive që kanë kaluar dhe nuk mund të kenë kurrfarë efekti juridik në Republikën e Kosovës sepse në Kosovë kërkohet të zbatohen dispozitat e Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, kërkesat e punëtoreve, rregullativa juridike që është përparimtare dhe jo ajo e cila është konstatuar në vendimin e ankimuar. Ankuesi me tej ka pohuar se vendimi i ankimuar përbën shkelje drastike të të drejtave të njeriut, pastaj të gjitha dispozitave tjera pozitive që e rregullojnë këtë materie dhe Kushtetutën e Kosovës.

Me 01 prill 2023, e paditura parashtroi përgjigje në ankesë, në të cilën pohoi se AL-ja ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkëlur nga AL-ja në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton si në vijim.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio

Kërkesa e ankuesit ka të bëjë me tre pagat e pa paguara, për muajt janar, shkurt, mars 2007, në shumë prej 900.00 €, të cilat pretendohet të mos jenë paguar nga ana e NSH-së. Neni 40 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP parasheh prioritetin e kërkesave dhe interesave që duhet të përmbushen në procedurë të likuidimit, ndërsa pika 1.6.1 e po të njëjtit nen, parasheh pagesën e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person.

Gjykata gjen se kërkesa e ankuesit është e pabazuar për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në neni 40, paragrafi 1.6.1 i referohet vetëm prioritetit të tri (3) pagave të fundit të papaguara.

Prioriteti i lartë megjithatë nuk ia njeh automatikisht të drejtën e punëtorit për tri pagat por i jep prioritet në mesin e borxheve të tri pagave të fundit të cilat mund të kenë mbetur pa u paguar. Në çdo rast, një kërkesë e tillë duhet të jetë e mbështetur me prova, me anë të së cilave do të vërtetohej fakti se NSH i ka mbetur borxh ankuesit pagat e kërkuara, prandaj vendimi i AL në këtë aspekt është i arsyetuar drejtë dhe saktë.

Për më tepër ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH-ja i ka mbetur borxh 3 pagat e kërkuara, po ashtu ankuesi nuk ka dorëzuar ndonjë specifikacion se për cilët muaj i kërkon pagat, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për 3 paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Njëherit ankesa e ankuesit është edhe e parashkruar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksa Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e objektit të kontestit është nën 1,000.00 Euro.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare